VENDIM
Nr. 810, datë 26.12.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVETË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I SHESHIT 'SKËNDERBEJ', FAZA II", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i sheshit 'Skënderbej', faza II", Tiranë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 212 313 708 (dyqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë 212 313 708 (dyqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, do të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i vitit 2018, i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronarët e përmendur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Tiranë.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHE NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I SHESHIT "SKËNDERBEJ"" (FAZA E II-TË)

Nr	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. i Pasurisë	Sip. totale truall (m²)	Sip. truall i prekur (m²)	Çmimi truall lek/m²	Sip. obj. totale (m²)	Sip. obj. e prekur (m²)	Çmimi obj.lek/m²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë	Konfirmimi I ZVRPP
1	Alban Xhillari	Truall	8150	1/364	71.60	71.60	66,969				4,794,980.4		Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
2	Iliria Holding sh.a.	Truall	8150	1/365	450.00	254.00	66,969				17,010,126		Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
3	25 Pronarë Deliu, Seferi	Truall	8150	1/195	76.40	67.00	66,969				4,486,923		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
4	Iliria Holding sh.a.	Truall	8150	1/375	92.40	92.40	66,969				6,187,935.6		Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
5	Bashkepronarët Gjinali, Asllani etj.	Truall	8150	1/200	293.30	206.00	66,969				13,795,614		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
6	Bashkepronarët Gjinali, Asllani etj.	Truall	8150	1/201	31.20	31.20	66,969				2,089,432.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
7	Bashkpr.Hoxholli, Deliu etj.	Truall	8150	1/495	231.00	231.00	66,969				15,469,839		Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
8	Vasil Beqari, Vladimir Beqari, Andon Beqari	Truall	8150	1/229	180.00	78.00	66,969				5,223,582		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
9	Harun Miniri	Ndërtesë	8150	1/6 - ND				108.00	108.00	24899	2,689,092	Në seksionin D dhe E të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
10	Diana Sallaku, Irina Kashari, Edlira Majollari, Naxhije Sallaku	Godinë	8150	1/7	193.80	193.80	66,969	1154.00	1154.00	27574	44,798,988.2	Në përshkrimin e veçantë ka shënimin: 1.Sip. Bodrumi 180 m2 2. Sip. Kati parë 194.8 m2 3.Sip. Kati i dytë 194.8 m2 4. Sip. Kati i tretë 194.8 m2 5. Sip. Kati i katërt 194.8 m2 5. Sip. Kati i pestë 194.8 m2	Nr. prot. 33853/1, datë 03.10.2018.
11	Harun Miniri	Truall	8150	1/248	50.20	50.20	66,969				3,361,843.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
12	Tonc Koka, Kole Koka, Elisabeta Koka, Jolanda Koka	Truall	8150	1/191	121.20	121.20	66,969				8,116,642.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
13	Alban Xhillari	Truall	8150	1/401	26.00	26.00	66,969				1,741,194		Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
14	Mazllëm Baraku	Truall	8150	1/413	24.00	24.00	66,969				1,607,256	Në seksionin D të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
15	Mazllëm Baraku	Truall	8150	1/414	24.00	24.00	66,969				1,607,256	Në seksionin D të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.06.2017.
16	Harun Miniri	Truall	8150	1/387	22.50	22.50	66,969				1,506,802.5		Nr. prot. 1754/3, datë 30.03.2018.
17	Andromaqi Kotorri	Truall	8150	1/211	106.00	106.00	66,969	20.00	20.00	32956	7,757,834	Në përshkrimin e veçantë ka shënimin: "Mbi këtë truall ka 86 m2 ndërtim pa leje." Vendoset	Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.

												sekuestro konservative nga zyra permb. "ARDAEL", permb. Gjyq. Ardian Elezi. Bllokohet në favor të Alpha Bank sha për shumën 13000000. Bllokohet në favor të Alpha Bank sha për shumën 11730000.	
18	Skender Çali	Truall	8150	1/212	32.00	32.00	66,969				2,143,008		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
19	PPV	Truall	8150	1/11	97.00	97.00	66,969				6,495,993		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
20	PPV	Truall	8150	1/12	177.2	177.20	66,969				11,866,906.8	Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje	Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
21	Shoqëria "Lani" sh.p.k, ortak i vetëm Vladimir Kosta	Truall	8150	1/185	831.5	183.00	66,969				12,255,327		Nr. prot. 18833/11, datë 29.08.2017.
22	Shefqet Dizdari	Truall	8150	1/484	35.9	35.90	66,969				2,404,187.1		
23	Shefqet Dizdari	Truall	8150	1/374	191.00	38.00	66,969				2,544,822		Nr. prot. 38958/1, datë 12.01.2018.
24	Harun Miniri	Ndërtesë	8150	1/500 - ND				36.2	36.20	38193	1,382,586.6	Kjo pasuri ndodhet mbi truallin 1/500, vol. 48, fq. 51, në emër të Shtetit; E vlefshme për të rregulluar marrëdhëniet me truallin.	Nr. prot. 1754/3, datë 30.03.2018.
25	Fatmir Mema	Truall	8150	1/386/2	63.00	63.00	66,969				4,219,047		Nr. prot. 1754/3, datë 30.03.2018.
26	Bashkepronarët, Haxhinasto, Antoni, Zografi etj.	Truall	8360	6/205	44.20	10.70	66,969				716,568.3		Nr. prot. 18833/1, datë 09.06.2017.
27	Nazmi Kodra	Njësi	8150	1/386-N	65.60	65.60	66,969	131	131.20	33468	8,784,168.0		Nr. prot. 1754/3, datë 30.03.2018.
28	Fatmir Mema	Apartament	8150	1/386+1-1	65.60	65.60	66,969	131.2	131.20	98038	17,255,752.0		Nr. prot. 1754/3, datë 30.03.2018.
Total						**2367**	**m2**		**1581**	**m2**	**212,313,708**	**lekë**	